



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2701/ 11 prot.

Datë 08/11/2024

V E N D I M
Nr. 1583/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08/11/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1520/2024, datë 29.10.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-13048-07-12-2024, me objekt: Loti III “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 15,065,918 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 150,149 (njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 11.07.2024 është 100.34 lekë, zhvilluar më datë 14.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a

Ankimues:

Operatori ekonomik “Argent Daci” P.F me NIPT L01914003T dhe adresë: Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godina Nr.21, poshtë kthesës së Valiasit, Kamëz, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK me NIPT J71601012S dhe adresë: Rruga Tiranë - Dajt, Zona Kadastrale 2460, me Nr. pasurie 199/24 dhe Nr.pasurie 199/32-G3, Lagjja Qesarak, Tiranë.

Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK me NIPT K72218022J dhe adresë: Rruga “Budi”, Pallati shoqerise “Rogerd”, Njesia Nr. 33, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 29.10.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1520/2024, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Argent Daci” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-13048-07-12-2024, me objekt: Loti III “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 15,065,918 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 150,149 (njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 11.07.2024 është 100.34 lekë, zhvilluar më datë 14.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Argent Daci*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 846/39 prot., datë 04.11.2024, protokolluar me tonën nr. 2701/8 prot., datë 05.11.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1520/2024, datë 29.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-13048-07-12-2024, me objekt: Loti III “*Blerje Mish dhe nënproduktet e tij*”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 15,065,918 (*pesëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH, ose 150,149 (*njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë*) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 11.07.2024 është 100.34 lekë, zhvilluar më datë 14.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 846/39 prot., datë 04.11.2024, protokolluar me tonën nr. 2701/8 prot., datë 05.11.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1520/2024, datë 29.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-13048-07-12-2024, me objekt: Loti III “*Blerje Mish dhe nënproduktet e tij*”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 15,065,918 (*pesëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH, ose 150,149 (*njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë*) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 11.07.2024 është 100.34 lekë, zhvilluar më datë 14.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1520/2024 datë 29.10.2024, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e

procedurës duke rishikuar statusin operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK ku nga i kualifikuar rezulton i skualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1520/2024, datë 29.10.2024 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-13048-07-12-2024, me objekt: Loti III “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 15,065,918 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 150,149 (njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 11.07.2024 është 100.34 lekë, zhvilluar më datë 14.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

